


AKT – THEMELIMI



I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ALBITAL CANON"

Sot me date 22.02.1999 ne perputhje me ligjin nr 7638 date 19.11.1992 "PER SHOQERITE TREGETARE" dhe Legjislacionin Shqiptar, perpilohet ky akt – themelimi me ortaket e meposhtem:

1. SERVET KASA, i datelindjes 06.10.1967, banues ne Durres, lagja 6, rr. Maliq Muco, nr. 17
2. ARTUR LLAZO, i datelindjes 10.05.1962, banues ne Durres, lagja 11, rr. A.Goga, pallati 758.
3. MIKEL LLAZO, i datelindjes 05.05.1965, banues ne Durres, lagja 11, rr. A.Goga, pallati 758.

NENI 1

OBJEKTI I SHOQERISE

- 1/1 -Prodhim i kompjuterave dhe aksesoreve te tyre, prodhim programesh te ndryshme dhe prodhim mobiljesh zyre.
- 1/2 -Administrim i laboratorit dhe asistence teknike e prodhimeve te pikes 1/1.
- 1/3 -Tregeti me shumice e pakice i prodhimeve te kompjuterizuara, brenda dhe jashte vendit.
- 1/4 -Dhenie e konsulences ne drejtim te organizimit per kompjuterizimin e shoqerive.
- 1/5 -Organizim kursesh per pregatitjen e analisteve dhe programatoreve.
- 1/6 -Kryerje operacionesh tregtare dhe financiare, import – eksport mallrash ushqimore, industriale te ndertimit etj.
- 1/7 -Shitblerje e pasurise se paluajteshme, dhenia e tyre me qera dhe sherbime te ndryshme per shoqerite tregtare.

NENI 2

EMERTIMI I SHOQERISE

- 2/1 -Emertimi i shoqerise eshte "ALBITAL CANON" sh.p.k
- 2/2 -Selia e shoqerise eshte ne Durres, lagja 4, rr. Skenderbej nr. 51.
- 2/3 -Shoqeria mund te krijojte filiale, zyra perfaqesimi dhe te zhvilloje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Shqiperise.

NENI 3

REGJIMI JURIDIK

- 3/1 -Shoqeria eshte me pergjegjesi te kufizuar dhe fiton personalitet juridik qe nga momenti i regjistrimit ne Regjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane.

NENI 4

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

- 4/1 -Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe mbi 10 vjet.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

- 5/1 -Kapitali themeltar eshte 100000 leke dhe kontributi i ortakeve eshte si vijon:
 1. Servet Kasa:leke 50.000 (50%)
 2. Artur Llazo:leke 25.000 (25%)

3. Mikel Llazo: leke 25.000 (25%)

ADMINISTRIMI

-Administratori i shoqerise eshte caktuar z. Servet Kasa, i biri i Rexhepit, i datelindjes 06.10.1967, lindur dhe banues ne Durres, lagja 6 rr Maliq Muco nr. 17

-Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te ortakeve, qe perfaqesojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar.

-Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise.

-Administratori pergjigjet individualisht ndaj shoqerise per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te tjera te kryera gjate administrimit. Kjo pergjegjesi eshte jo vetem per shyerjen e demit, por eshe penale, ne rast se e kerkojne ortaket.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

-Vendimet ne mbledhjen e asamblese merren nga nje ose disa ortake, qe perfaqesojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar, ndersa per ndryshimet e statutit kjo perqindje duhet te jete me shume se $\frac{3}{4}$

-Mbledhjet e asamblese zhvillohen pasi ortaket te jene lajmeruar 15 dite perpara, nga administratori, ose eksperti i autorizuar, me leter rekomande, ku te njoftohet rendi i dites.

-Pas miratimit te llogarise vjetore dhe evidencimit te ekzistences se shumave qe do te shperndahen, asambleja percakton pjesen qe u takon ortakeve ne forme dividendesh.

NDARJA E FITIMEVE

-Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane per rezerven, si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e bartura nga vitet e meparshme.

LIKUIDIMI

-Likuidimi behet ne rast se shoqeria prishet nga perfundimi i afatit, ose me vendim te ortakeve qe perfaqesojne shumicen e kapitalit.

-Likuidatori caktohet me vendim te ortakeve dhe kur ata nuk bien dakort me vendim te gjykates.

-Ndarja e kapitaleve te veta qe mbeten pas pagimit te detyrimeve, behet ndermjet ortakeve, ne perpjestim me kontributin e tyre ne kapitalin themeltar.

-Neqoftese ortaket nuk vendosin per bilancin financiar perfundimtar, dhe mbylljen e proccsit te likuidimit, vendimi merret nga Gjykata, me kerkesen e likuidatorit ose te cdo personi te interesuar.

MOSMARREVESHJET

-Mosmarreveshjet zgjidhen me mirekuptim. Ne rast te kundert kalojne ne gjykaten e rrethit Durres per shqyrtim.

Ky akt - themelimi u perpilua ne 5 kopje dhe firmoset me vulnet te lire nga ortaket.

SERVET KASA

ORTAKET

ARTUR LLAZO

MIKEL LLAZO

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES

NR REP

440 rep - Nr. 187 Kel.

VERJETIM

Sot me date 22.02.1999 dite e hene para meje noterit publik ALI TURKU u paraqiten personalisht te sipepermendurit, me zotasi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova nga pasaportat personale dhe me vullnet te lire e ne pranine time firmosen kete akt themelim.



**NOTERI
ALI TURKU**



STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ALBITAL CANON" sh.p.k

Themeluesit e kesaj shoqerie jane ortaket:

1. SERVET KASA, i datelindjes 06.10.1967, lindur dhe banues ne Durres, lagja 6, rr. Maliq Muco, nr. 17.
2. ARTUR LLAZO, i datelindjes 10.05.1962, lindur dhe banues ne Durres, lagja 11, rr. A.Goga, nr. 758.
3. MIKEL LLAZO, i datelindjes 05.05.1965, lindur dhe banues ne Durres, lagja 11, rr. A.Goga, nr. 758.

te cilet ne perputhje me ligjin nr 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" dhe Legjislacionin Shqipetar, hartojne kete statut.

NENI 1

OBJEKTI I SHOQERISE

- 1/1 - Prodhim i kompjuterave dhe aksesoreve te tyre, prodhim programesh te ndryshme dhe prodhim mobiljesh zyre.
- 1/2 - Administrim i laboratorit dhe asistence teknike e prodhimeve te pikes 1/1.
- 1/3 -Tregeti me shumice e pakice i prodhimeve te kompjuterizuara, brenda dhe jashte vendit.
- 1/4 -Dhenie e konsulences ne drejtim te organizimit per kompjuterizimin e shoqerive.
- 1/5 -Organizim kursesh per pregatitjen e analisteve dhe programatoreve.
- 1/6 -Kryerje operacionesh tregetare dhe financiare, import - eksport mallrash ushqimore, industriale te ndertimit etj.
- 1/7 -Shitblerje e pasurise se paluajtshme, dhenia e tyre me qera dhe sherbime te ndryshme per shoqerite tregetare.

NENI 2

EMERTIMI DHE SELIA E SHOQERISE

- 2/1 -Emertimi i shoqerise eshte "ALBITAL CANON" sh.p.k
- 2/2 -Selia e shoqerise eshte ne Durres, lagja 4, rr. Skenderbeu, nr. 51.
- 2/3 -Shoqeria mund te krijojte filiale, zyra perfaqesimi dhe te zhvilloje aktivitetin e saj ne te gjithë territorin e RSH, ndersa leja e ushtrimit te profesionit do te nxirret vetem ne rrethin ku ka qendruar personi juridik.

NENI 3

REGJIMI JURIDIK

- 3/1 -Shoqeria eshte me pergjegjesi te kufizuar dhe i nenshtrohet Aktit te Themelimit, Statutit, Ligjit "Per Shoqerite Tregetare" dhe Ligjit te Legjislacionit Shqipetar.
- 3/2 -Shoqeria fiton personalitet juridik qe nga momenti i regjistrimit ne Regjistrin Tregetar prane Gjykates se Rrethit Tirane.

NENI 4

KOHEQENDRIMI I SHOQERISE

- 4/1 -Shoqeria do te zhvilloje veprimtarine e saj per nje periudhe mbi 10 vjet me te drejte zgjatje te afatit, ose zgjidhje parakohe, sipas vendimit te asamblese.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR - ASAMBLEJA - TRANSFERIMET

- 5/1 -Kapitali themeltar eshte 100.000 leka, dhe kontributi i ortakeve ne perqindjes eshte si vijon:



- 1.SERVET KASA: 50%
- 2.ARTUR LLAZO: 25%
- 3.MIKEL LLAZO: 25%
- 5/2 -Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakëve ne rruge trashegimie dhe ne rast ndarje pasurore midis ortakëve.
- 5/3 -Bashkeshorti, trashegimtari behen ortakë nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar, vetem pasi te jene miratuar nga ortakët.
- 5/4 -Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen te treteve qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e shumices se ortakëve, qe perfaqesojne te pakten $\frac{3}{4}$ e pjeseve te kapitalit themeltar. Projekti i transferimit i njoftohet shoqerise dhe secilit prej ortakëve, dhe nese shoqeria nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda 3 muajve, miratimi i transferimit konsiderohet i dhene. Ne rast se shoqeria refuzon te jape miratimin e transferimit, ortakët brenda 3 muajve duhet t'i blejne, apo te lejojne blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar.
- 5/5 -Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me akt noterial.
- 5/6 -Shoqeria ka te drejte, kur bie dakort, te lere peng pjese te kapitalit themeltar. Ne rast shitje te detyruar te pjeseve te lena peng, pengmarresi do te pranohet si person qe i transferohen pjeset e kapitalit themeltar.
- 5/7 -Ortakët shlyejne ne kohe, si kontributet ne natyre, ashtu dhe ne para. Ata nuk mund te perfaqesojne kontribute ne sherbime.
- 5/8 -Kapitali themeltar ndahet ne pjese te barabarta, vlera nominale e te cilave eshte 1000 leke, me numer rendor 1-100. Kuotat mbi 1000 leke kane te drejten e nje vote per cdo 1000 leke.
- 5/9 -Zmadhimi i kapitalit me ane te kontributit ne para behet me depozitimim ne banke, brenda 8 diteve nga grumbullimi i tyre.
- 5/10 -Zmadhimi i kapitalit themeltar me ane te kontributeve ne natyre mund te behet pasi ato te vleresohen nga nje ekspert per kontributet, i emeruar me unanimitetin e ortakëve, ose me vendim gjyqi, sipas kerkeses se njerit prej ortakëve. Por ortakët mund te vendosin me unanimitet qe te mos drejtohen tek nje ekspert per kontributet, neqoftese vlera e cfo kontributi ne natyre nuk tejkalon vleren e kapitalit minimal te vlefshem per krijimin e shoqerise, dhe neqoftese vlera e pergjithshme e bashkesise se kontributeve ne natyre nuk tejkalon gjysmen e kapitalit themeltar.
- 5/11 -Zvogelimi i kapitalit themeltar lejohet nga asambleja e ortakëve me vendim te ortakëve qe perfaqesojne te pakten $\frac{3}{4}$ e pjeseve te kapitalit themeltar. Zvogelimi prek ortakët ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.
- 5/12 -Ne rast se kapitalet e veta te shoqerise, per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentet financiare, rezultojne me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar, ortakët vendosin brenda 4 muajve nga miratimi i llogarive qe pasqyrojne keto humbje, mbi mundesine e prishjes se parakohshme te shoqerise.
- Neqoftese prishja nuk shpallet nga shumica e kapitalit prej $\frac{3}{4}$,



shoqeria detyrohet të zvogelojë kapitalin e saj me një vlerë jo më të vogël se ajo e humbjeve që kanë mbetur të pambuluara nga rezervat, por duke pasur parasysh rregullat për minimumin e kapitalit themeltar. Ky operacion duhet të kryhet jo më vonë se mbyllja e vitit financiar pasardhës, para të cilit është konstatuar humbja, nëse brenda këtij afati kapitalet e shoqërisë nuk janë plotësuar në një vlerë jo më të vogël se gjysma e kapitalit themeltar. Kur ortakët nuk kanë mundur të marrin një vendim të tillë, çdo person i interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Edhe gjykata mund të vendosë prishjen e shoqërisë, pasi i ka akorduar një afat maksimal prej 6 muajsh për të rregulluar gjendjen.

NENI 6

TE DREJTAT E SHOQËRISË DHE ORTAKËVE

6/1

-Shoqëria ka të drejtë të lidhë kontrata dhe të nënshkruajë marrëveshje brenda dhe jashtë vendit.

6/2

-Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortak në shoqëri të tjera.

6/3

-Shoqëria përgjigjet ndaj të treteve, vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e derdhur, duke u përjashtuar përgjegjësia personale e çdo ortaku.

6/4

-Ortakët përballojnë humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

6/5

-Shoqëria nuk prishet kur falimenton ose shfaq paaftësi njeri prej ortakëve. Ajo nuk prishet kur vdes një ortak.

6/6

-Transferimi i të drejtave të një ortaku ose riblerja e tyre nga shoqëria në rast mospranimi, bëhet nga një ekspert që caktohet nga palet, dhe kur ato nuk merren vesh prej tyre, ai caktohet nga gjykata me procedurë urgjente dhe vendim të formës së prërë.

6/7

-Ortakët mund të emerojnë eksperte kontabel të autorizuar. Janë të detyruar të caktojnë ekspert kontabel të autorizuar të pakten ato shoqëri, që në mbyllje të ushtrimit financiar tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

-Totali i aktivitetit të bilancit: 6 miliona leke

-Totali i të ardhurave : 12 miliona leke

-Numri mesatar vjetor i të punësuarve: 10 vete.

6/8

-Ortaku ka të drejtë të marrë në çdo moment raportin e administrimit, inventarin, llogaritë vjetore për tre vitet e fundit financiar, duke qenë i ndihmuar po të jetë nevoja, nga një ekspert i zgjedhur prej tij, i cili i nështrohet detyrimit për ruajtjen e sekretit personal.

6/9

-Ortakët individualisht ose në grup, kanë të drejtë të ngrenë padi kundër administratorit për shlyerjen e dëmit, ose padi penale. Asnjë vendim i asambleës nuk mund të ndalojë kerkese padin kundër administratorit.

6/10

-Një ose disa ortakë që përfaqësojnë të pakten 1/10 e pjesëve të kapitalit themeltar, mund të kërkojnë në rrugë gjyqësore caktimin e një eksperti për paraqitjen e një raporti për një ose disa vendime administrative.

6/11

-Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar, nuk prishet kur falimenton ose vdes njeri prej ortakëve.

6/12

-Një shoqëri me pjesëmarrje të investimeve të huaja ka të drejtë të punësojë edhe shtetas të huaj.



6/13

-Shtetasit e huaj kane te drejte te transferojne jashte territorit te RSH, te gjitha fondet dhe kontributet ne natyre. Ky transferim mund te behet ne monedhe lehtesisht te konvertueshme.

NENI 7

7/1

DETYRAT E ORTAKEVE

-Ortaket detyrohen te depozitojne kontributin e tyre ne kapitalin themeltar.

7/2

-Cdo ortak detyrohet te siguroje ne kohe dhe plotesisht detyrimet e tija ndaj shoqerise dhe ortakeve te tjere.

7/3

-Kur ortaku nuk i pergjigjet detyrimeve, atehere ortaku tjetër, pasi e ka njoftuar dhe nuk ka plotesuar detyrimin, kerkon demshperblimin.

NENI 8

8/1

-Administratori i vetem i shoqerise eshte z. Servet Kasa, i biri i Rexhepit, i datelindjes 06.10.1967, lindur dhe banues ne Durres, lagja 6, rr. Maliq Muco, nr. 17.

8/2

-Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te ortakeve, qe perfaqesojne me teper se 1/2 e pjeseve te kapitalit themelta. Ai i ka te gjitha kompetencat qe ligji ia jep ortakeve

8/3

-Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep ortakeve.

8/4

-Shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e administratorit dhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektet e shoqerise. Ajo nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise.

8/5

-Administratoret ose ortakët qe nuk jane persona juridike, nuk u lejohet te kontraktojne ne cfaredo lloj forme qofte, te marrin hua nga shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj per parardhenie, si dhe te behen dorezues apo te garantojne ne emer te saj, angazhimin ndaj te treteve.

8/6

-Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

8/7

-Pervec padise per shlyerjen e demit qe u ngarkohet personalisht, ortakët, individualisht ose ne grup, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

8/8

-Administratori shkarkohet me vendim te ortakeve qe perfaqesojne me teper se gjysmen e kapitalit themeltar. Administratori shkarkohet nga gjykata per shkelje te ligjit, me kerkese te çdonjerit prej ortakeve.

8/9

-Raporti i administrimit, inventaret, dhe llogarite vjetore te hartuara nga administratori, i nenshtrohen miratimit te asamblese se ortakeve, brenda 6 muajve, duke filluar nga data e e mbyljes se vitit financiar.

NENI 9

9/1

ASAMBLEJA E ORTAKEVE


-Te gjitha vendimet merren nga asambleja.

9/2

-Ortakët lajmërohen me leter rekomande te pakten 15 dite perpara mbledhjes, ku njoftohet rendi i dites.

9/3

-Lajmerimi behet nga administratori, ose ne mungese te tij, nga eksperti kontabel i autorizuar.



9/4
9/5
9/6
9/7

-Mbledhjen e asamblese mund ta kerkojne nje apo disa ortake qe perfaqesojne te pakten 10% te pjeseve te kapitalit themeltar.

-Cdo ortak merr pjese ne vendime, me numrin e votave qe i pergjigjen pjeseve te kapitalit themeltar.

-Cdo ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjetër.

-Ne mbledhjen e asamblese vendimet merren nga nje ose disa ortake qe perfaqesojne me shume se gjysmen e pjeseve te kapitalit themeltar. Kur nuk sigurohet kjo shumice, ortakët thirren per here te dyte dhe vendimet merren me shumice votash, pavaresisht nga perqindja e kapitalit qe ato perfaqesojne.

9/8

-Ndryshimet e statutit vendosen nga ortakët qe perfaqesojne te pakten ¾ te pjeseve te kapitalit themeltar.

NENI 10

10/1
10/2

VITI FINANCIAR-NDARJA E FITIMEVE

-Cdo vit financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor.

-Ne fillimin e vitit financiar, nga fitimi i realizuar, pasi te jene zbritur po te jete e nevojshme humbjet e vitit te meparshem, lihet nmerjehere nje shume sa 1/20 e tij, e cila quhet "Rezerve e Domosdoshme" dhe mbaron kur kjo shume arrin 1/10 e kapitalit themeltar.

NENI 11

11/1

LIKUIDIMI

-Shoqeria eshte ne likuidim e siper qe ne momentin e prishjes se saj dhe pasohet nga shenimi "Shoqeri ne likuidim e siper". Shoqeria ekziston si person juridik per nevojat e likuidimit deri ne momentin e perfundimit te ketij procesi.

11/2

-Likuiduesi emerohet ne rast se prishja mjedh nga perfundimi i afatit te percaktuar ne statut, ose n.q.s prishja vendoset nga ortakët, e pelqimin e shumices per nga kapitali i ortakeve.

11/3

-N.q.s ortakët nuk kane mundur te emerojne nje likuidues, ose prishja e shoqerise eshte bere me vendimte gjyqi, gjykata cakton likuidatorin.

11/4

-Likuiduesi perfaqeson shoqerine dhe ka te gjitha kompetencat per shitjen e aktivitet, per pagimin e kreditoreve.

11/5

-Likuiduesi harton brenda tre muajve nga mbyllja e odo viti financiar llogarite vjetore per operacionet e likuidimit gjate vitit financiar te kaluar.

11/6

-Ndarja e kapitaleve te veta, qe mbeten pas pagimit te pjeseve te kapitalit themeltar, behet ndermjet ortakeve ne perpjestim te njejte me kontributin e tyre ne kapitalin themeltar.

11/7

-Ortakët thirren ne fund te procesit te likuidimit qe te vendosin per bilancin financiar perfundimtar dhe per mbylljen e procesit te likuidimit. N.q.s mbledhja e asamblese nuk merr vendim ose nuk pranon te miratoje llogarite e likuiduesit, vendimi merret nga gjykata me kerkesen e likuiduesit, ose te odo personi te interesuar.

11/8

-Gjykata merr vendim per llogarite dhe ne rast se eshte e nevojshme, per mbylljen e likuidimit.

NENI 12

12/1

MOSMARREVESHJET

-Zgjidhen me mirekuptim ndermjet ortakeve. Ne te kundert, ceshtja kalon Gjykes.

Ky statut perpilohet ne 5 kopje dhe firmoset me vulnet te lire nga ortaket.

ORTAKET

SERVET KASA



ARTUR LLAZO




MIKEL LLAZO



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
NR 440 REP NR 185 KOL

VENDIM

Sot me date 22.02.1999 dite e hene para meje noterit publik ALI TURKU u paraqiten personalisht te siperpermendurit me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova nga pasaportat personale dhe me vulnet te lire dhe ne pranine time firmosen kete statut.



NOTERI
ALI TURKU

